

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“ALZEN” SH. P. K.**

Sot, më datën 09/11/2021 Z.Muharian Pistolja lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, Shqiperi, me datë 31.10.1979 dhe Z. Slobodan Bogdanić, i lindur dhe banues në Teslić, Bosnje me datë 26/01/1967, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**ALZEN**” Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “**ALZEN**”.

Ortaket e shoqërisë janë Z.Muharian Pistolja dhe Z.Slobodan Bogdanić  
Administrator te kësaj shoqërie caktohen Z.Muharian Pistolja dhe Z.Slobodan Bogdanić.  
Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “**ALZEN**” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh.P.K.**”. Veprimitaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “**ALZEN**” Sh. P. K është Durres Lagija 4, Rruga Fetah Blaca, Pallati 1133, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.  
Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënët të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimitaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Prodhim veshje kembe, konfeksione te ndryshme si dhe tregtim i tyre brenda dhe jashtë vendit me shumice dhe pakice.
- Import-Export, tregti te artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice dhe pakice, veshje per femije, burra, gra, veshje kembe lekure, tesut, plastike, etj. aksesore per prodhim veshje kembe, konfeksione, etj.
- Perpunim aktiv me mall porositesi

**Neni 5**

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

**Z. Muharian Pistolja** zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme 51.000 leke që përbën 51% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Slobodan Bogdanić** zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme 49.000 leke që përbën 49% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakve mund te jetë ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**


Marrëdhëni e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themeli dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKET E SHOQËRISË**

**MUHARIAN PISTOLJA**

Muharijan Pistolja  


*Slobodan Bogdanic'*  
**SLOBODAN BOGDANIC**

*Bogdanic'*